

## **SHTESË AUTORIZIMI ZYRTAR**

**Nr.1, datë 20.7.2002**

### **PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI**

Në mbështetje të Ligjit nr. 8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit", si dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, me vendim nr.20, datë 19.7.2002:

#### **A U T O R I Z O N:**

Shoqëria anonime "Siguria e Madhe" Sh.a, me emrin e shkurtuar "SIGMA" sh.a. me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e rrethit Tiranë me nr. akti 20484, të kryejë sigurime për dëmet, në përputhje me lejen e riformuluar dhe për zgjerim aktiviteti.

Leje e riformuluar për zgjerim të aktivitetit të sigurimeve dhe/ose risigurimeve

Shoqëria e sigurimeve "Sigma" sh.a. e regjistruar në gjykatën e rrethit Tiranë me nr.akti 20484 me seli në Tiranë në adresën Sheshi Wilson, që ushtron aktivitet në fushën e sigurimeve në bazë të autorizimit nr.1, datë 3.2.1999, lejohet të zgjeroj aktivitetin e saj të sigurimeve edhe në grupe të tjera të papërfshira në lejen e mëparshme, bazuar në lejen e riformuluar në përputhje me shtojcën B të ligjit nr. 8081 datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë në sigurime dhe/ose risigurime" si më poshtë vijon:

Grupi nr.1 dhe nr.2 "Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit".

Grupi nr.1 (paragrafi i katërt) 3,7 dhe 10 "Sigurime motorrike".

Grupet nr.1 (paragrafi i katërt) 4, 6, 7 dhe 12 "Sigurimi i marinës dhe transportit".

Grupet nr.1 (paragrafi i katërt) 5,7 dhe 11 "Sigurimi i avionëve".

Grupet nr.8 dhe 9 "Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë".

Grupet nr.10, 11,12 dhe 13 "Sigurimi i përgjegjsive"

Grupet nr.14 dhe 15 "Sigurimi i kreditit dhe garancive".

Kjo leje e riformuluar dhe për zgjerim aktiviteti është pjesë përbërëse dhe i bashkëngjitet shtesës së autorizimit zyrtar nr.1 datë 20.7.2002.

U lëshua sot më datë 11.11.2002 nga Komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve dhe i shtrin efektet menjëherë.